**R E P U B L I K A  E  S H Q I P Ë R I S Ë**
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
**KABINETI**

*Bulevardi "Bajram Curri" Tirana, Albania - Tel/Faks. +355 4 36462937 - www.moh.gov.al*

*Nr. _______ Prot.* *Tiranë, më ________2010*

**Lënda :** *Realizimi i treguesve të monitorimit financiar për Ministrinë e Shëndetësisë per 6 mujorin 2010.*

**Drejtuar : MINISTRISË SË FINANCAVE**
**DREJTORISË SË PËRGJTHSHME TË BUXHETIT**

Në zbatim të Ligjit Nr.9936 date 26.6.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" dhe ", Ligjit Nr.10190 date 26.11.2009 "Per buxhetin e vitit 2010", ne zbatim te Udhezimit Nr. 1 date 21.1.2010 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010 bashkëlidhur ju dërgojmë informacionin për realizimin e buxhetit të gjashtemujorit të parë 2010.
Në kollonën e buxhetit të vitit 2010 është shënuar buxheti vjetor ndërsa për sa i përket faktit të dhënat janë 6 mujore.

Shpenzimet buxhetore për 6 mujorin e parë të vitit 2010 për sektorin shendetesor paraqiten me nje realizim prej 50%. Po te marrim parasysh shkrutimet e fondeve te propozuara per vitin 2010, realizimi paraqitet ne masen 54%.

Sipas programeve buxhetore realizimi paraqitet si vijon:
- Programi planifikim menaxhim administrim 57%
- Programi Sherbime te kujdesit shendetesor paresor 70%
- Programi Sherbime te kujdesit shendetesor dytesor 43%
- Programi sherbime te shendetit publik 35%.

Po te analizojme realizimin sipas artikujve buxhetore ato paraqiten si vijon:

Paga 46%, sigurime 50%, shpenzime operative 30%, transferta e ISKSH 60% .

Për sa i përket realizimit të artikullit mallra dhe shërbime pjesa më e madhe e fondeve të këtij artikulli ne sherbimin spitalor prokurohen nga vete spitalet.

Buxheti i investimeve per Ministrine e Shendetesise i celur nga Ministria e Financave ne fillim te v.2010 ka qene ne vleren 5.476.138.000 leke, nga te cilat 4.301.000.000 leke per financimin e brendshem dhe 1.175.138.000 leke per financimin e huaj. Qe ne fillim te ketij viti eshte celur nje vlere e

konsiderueshme kundrejt totalit me emertimin **“Fond i ngrire”** dhe perkatesisht **1.539.595.008 leke** qe i takojne rreth **36%** te fondit total te financimit te brendshem prej **4.301.000.000 leke**.
Bazuar ne shkresen e Ministrise se Financave me nr.1735/1 date 17.02.2010, na u kerkua rishikimi i buxhetit te investimeve per kete vit, ku buxheti i ngurtesuar do te mbetej ne vleren 1.631.120.000 leke ne total.
Per periudhen e 6-mujorit te v.2010 kemi kete pasqyre te realizimit te investimeve, si me poshte vijon:

*Ne 000/leke*

| PROGRAM | Plani inv.brend v.2010 | Realizimi inv.brendshme v.2010 | % e realizimit te fin.brendsh | Plani i fin.huaj v.2010 | Realizimi i fin.huaj v.2010 | % e realizimit te fin.huaj |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **01110** | 50.162 | 35.033 | 70% | 0 | 0 | 0 |
| **07220** | 885.628 | 76.177 | 9% | 439.500 | 165.504 | 38% |
| **07330** | 3.205.210 | 873.870 | 27% | 735.638 | 319.400 | 43% |
| **07450** | 160.000 | 7.450 | 5% | 0 | 0 | 0 |
| **Totali** | **4.301.000** | **992.530** | **23%** | **1.175.138** | **484.904** | **41%** |

Sic e thame me siper ne pjesen e financimit te brendshem kemi nje vlere te konsiderueshme me emertimin “Fond i Ngrire”, si me poshte vijon:

| PROGRAM | **“Fond i Ngrire” v.2010- ne mije/leke** | **Plani i fin.brendshem pa fonde te ngrira** | Realizimi i inv.brendshme(pa f.ngrira). v.2010 | % e realizimit te fin.brendsh |
|---|---|---|---|---|
| **01110** | 3.364 | 46.798 | 35.033 | 75% |
| **07220** | 169.249 | 716.379 | 76.177 | 11% |
| **07330** | 1.390.118 | 1.815.092 | 873.870 | 48% |
| **07450** | 68.389 | 91.611 | 7.450 | 8% |
| **Totali** | **1.631.120** | **2.669.880** | **992.530** | **37%** |

Arsyet e nje perqindjeje te ulet te realizimit te investimeve per 6-mujorin e v.2010 jane, si me poshte vijojne:

- Rishikimi i planit te investimeve, bazuar ne shkresen e Ministrise se Financave me nr.1735/1 date 17.02.2010, i aprovuar nga kjo e fundit me nr.1735/71 date 06.04.2010, beri qe per shume objekte investimi te fillonin procedurat e tenderimit pas kesaj date, kjo si per objekte te

celura qe ne fillim te vitit, pasi pati ndryshime te vlerave te alokuara, por dhe per objekte te reja te miratuara me rishikimin e investimeve.

- Nje vlere te konsiderueshme ne planin e investimeve per pjesen e sherbimit te kujdesit paresor ka dhe Fondi i Zhvillimit te Rajoneve, 297.000.000 leke. Per realizimin e ketij fondi duhej ndjekur nje procedure e vecante bazuar ne nje udhezim te Ministrise se Financave dhe vendim te Keshillit te Ministrave, i cili i ben efektive per te vepruar njesite e qeverisjeve vendore pas dates 15 korrik 2010. Ky fond ze rreth 40% te fondit te programit 07220 (te brendshme).
- Disa institucione te varesise se Ministrise se Shendetesise kane shpallur procedurat e prokurimit per disa nga objektet qe u jane alokuar per here te dyte, per arsye te moskonkurrences, per arsye te mosparaqitjes se duhur te ofertuesve bazuar ne DST-te, etj.
- Per disa procedura te kryera nga institucionet shendetesore jane lidhur tashme kontratat, por qe financimet per kete 6-mujor ende s'jane kryer, pasi nuk eshte levruar malli, apo nuk jane kryer punimet per ndertime ose rikonstruksione.

Nga Ministria e Financave eshte kerkuar nje pakesim ne planin e investimeve me nr.8127 dt.30.06.2010(ne kuader te buxhetit te rishikuar) duke futur ketu dhe fondet e ngrira.

***Ne mije/leke***

| **buxheti i rishikuar 2010 (qershor) MSH** | | |
|---|---|---|
| **fin brend** | **fin huaj** | **total** |
| **1.546.198** | **645.138** | **2.191.336** |

Duke pasur parasysh planin e mbetur(sipas tab.se mesiperme) dhe procedurat qe jane kryer tashme, por dhe ato qe jane ne proces e siper, vetem me realizimin e financimeve per 6-mujorin e pare te v.2010 kemi nje realizim prej 64% te investimeve te brendshme.

Bashkelidhur gjeni nje informacion lidhur me ecurine e financimeve te huaja.

**SEKRETARE E PERGJITHSHME**

**MIRELA CANO**